
Karta e apostollit Pavel mbë Ebrenjtë.

Krye 1.

- 1 Perëndia, passi u foli që-moti atërvet t' anë
me anë të profitërvet shumë herë e me shumë
2 mënyrëra, Ndë këto dit të-pastajme na foli
neve me anë të Birit, të-cilin' e bëri trashë-
gimtar të të-gjithave, me anë të të-cilit bëri
3 edhe jetëtë: I-cili, dyke qënë ndriçim' i lav-
disë edhe karakter' i qënjes' s' ati, edhe dy-
ke mbajturë të-gjitha me fjalën' e fuqis' së
ti, passi me anë të vetëhes' së ti qëroj faje-
të t'anë, ndënjti mbë të-djathtët të madhë-
4 risë ndë të-lartët *vënde*; Edhe ubë kaqë m'
i-mirë nga ëngjëjtë, sa më të-çquarë emërë
se ata ka trashëguarë.
- 5 Sepse cilit prej ëngjëjvet i tha ndonjë-
herë, "Ti jë biri im; unë sot të kam pjellë?,"
6 Edhe përsëri "Unë dot' i jem ati Atë, edhe
ay dotë më jetë Bir?," Edhe, kur të kllasë

përsëri të-parë lindurinë ndë botët, thotë,
 7 „Edhe let' i falen' ati gjithë ëngjëjt' e Perëndisë., Ethe për ëngjëjtë thotë,“ Ay që bën
 8 ëngjëjt' e ti frymëra, edhe punëtorët' e ti flakë zjarri.“ Po për të Birinë *thotë*, „Froni yt,
 o Perëndi, *është* ndë jetët të jetësë: shkop
 9 drejtërie *është* shkopi i mbretërisë s' ate. Deshë drejtërinë,
 e pate cmir paudhërinë; përandaj të leu,
 o Perëndi, Perëndia yt, me vaj gëzimi
 10 më tepërë se pjesëtarët' e tu.“ Edhe, “Ti ndë kryet,
 o Zot, themelose dhenë, edhe punëra
 11 të duarvet te tua janë qiejtë. Ata dotë prishenë,
 po ti mbetesh; edhe të-gjithë si rrobë
 12 dotë vjetëronenë, Edhe posi të-veshurë dotë i pshtjellç
 ata, edhe dotë ndërronenë; po ti je gjithay,
 edhe vjet' e tu nukë dotë shterenë.,
 13 Edhe cilit prej ëngjëjvet i tha ndonjëherë,
 “Rri prej së-djathtësë s' ime, gjersa të vë
 armiq' e tu ndënëkëmbje të këmbëvet të
 14 tua., Nukë janë të-gjithë frymëra punëtore,
 që dërgoanë për shërbesë për ata që kanë
 për të trashëguarë shpëtim?

Krye 2.

1 Përandaj duhetë neve më tepërë t' u' a vëmë
 veshnë atyreve që dëgjuamë, semos
 2 shkasëmë ndonjë' herë. Sepse ndë dolli e-vërtetë
 fjala që ufol me anë të ëngjëjvet, edhe çdo
 të-shkelurë *porosie* edhe të-mos-dëgjuarë
 3 mori mundim të-drejtë, Qysh neve dotë shpë-

tojmë, ndë mos ukujdesçimë për një kaqë të-math
 shpëtim? i-cili, passi zuri të flitetë prej
 Zotit, uvërtetua ndër ne prej atyreve që ë
 4 dëgjuanë; Edhe Zoti dëshmonte bashkë me shënja
 e me çudira, e me çdo farë fuqirash, edhe me të-ndara
dhurëtirash të Frymës' së-Shënjtëruarë,
 pas dashurimit të ti.
 5 Sepse nuk' e vuri ndënë pushtett të ëngjëjvet
 botënë që ka për të ardhurë, për të-6 cilënë
 po flasëmë. Edhe dikush dëshmoj mbë një vënt,
 dyke thënë, “Ç' është njeriu, që t'a kujtonjç?
 a i bir' i njeriut që t'a vështronjç?
 7 E bërë pak gjë më të-poshtërë nga ëngjëjtë;
 me lavdi e me nder e kurorëzove atë, edhe e vure
 përmbi punërat të duarvet të tua:
 8 Të-gjitha i vure përposh këmbëvet t' ati;“
 sepse passi vuri të-gjitha ndënë pushtett t' ati,
 nukë la asgjë të-pavënë ndënë pushtett t' ati.
 Po ndashti nukë shohëmë edhe të-9 gjitha
 të jenë vënë ndënë pushtett t' ati. Po Jisunë
 që qe bërë pak gjë më i-poshtërë nga ëngjëjtë
 e shohëmë, për pësimin' e vdekjesë, të-kurorëzuarë
 me lavdi e me nder, që me hirin' e Perëndisë
 të ngjëronetë vdekje për
 10 çdo njeri. Sepse i duhej ati, për të-cilinë
janë të-gjitha, edhe me anë të të-cilit *ubënë*
 të-gjitha, dyke prurë shumë bij ndë lavdi,
 të bënë me anë të-pësuarave të-sosurë kryetarin'
 e shpëtimin' t' atyreve.
 11 Me-qënë-që edhe ay që shënjtëron edhe

ata që shënjtëronenë *janë* të-gjithë prejnjëj; për të-cilënë ngajë nukë turpëronetë t' i qu-
 12 anjë ata vëllezër, Dyke thënë, "Dot' u rrë-
 fenj emërinë t'ënt vëllezërvet të mi, ndë mest
 13 të kishësë dotë të lavduronj., Edhe prapë,
 „Unë dotë kem shpresënë t' ime mb' atë,"
 Edhe përsëri, "Ja unë, edhe çunatë që më
 14 dha Perëndia." Edhe me-qënë-që çunatë kanë
 marrë pjesë prej mishi e gjaku, edhe ay
 gjithashtu mori pjesë prej gjithatyre *gjërëra-*
ve, që të prishnjë me anë të vdekjesë atë
 që ka pushtetin'e vdekjesë, do-me-thënë dja-
 15 llinë, Edhe të shpëtonjë gjith' ata, të-cilëtë
 për frikën' e vdekjesë ishinë gjithë-jetën' e
 16 *tyre* ndënë skllavëri. Sepse me të-vërtetë nuk'
 u ndih ëngjëjvet, po farës' s' Avraamit i ndih.
 17 Përandaj duhej t' u gjante së-gjithash vë-
 llezërvet, që të bënej kryëprift i-dhëmçurë
 edhe besëtar mbë punëratë që kanë të bënëj
 me Perëndinë, që të bënjë të-paqtuarë për
 18 fajet' e llauzit. Sepse mb' atë që pësoj vetë,
 kur unga, munt t' u ndihnjë atyreve që ngi-
 tenë.

Krye 3.

1 Andaj, o vëllezër shënjtorë, pjesëtarë te
 të-thërriturit prej qielli, vështroni apostollin
 edhe kryëpriftin' e rrëfimit t'ënë, Jisu Krish-
 2 tinë; I-cili është besëtar tek ay që e bëri, si-
 kundrë edhe Moisiu *qe besëtar* ndë gjithë

3 shtëpit t'ati. Sepse ky ulavduruu kaqë më
 tepërë se Moisiu, sa ka më shumë nder se
 4 shtëpia ay që e ndërtoj atë. Sepse çdo shtëpi
 ndërtonetë prej ndonjëj; po ay që ndërtoj të-
 5 gjitha *është* Perëndia. Edhe Moisiu qe besë-
 tar ndë gjithë shtëpit t'ati si shërbëtuar, për
 dëshmim t'atyre *gjërërave* që dotë flitëshinë;
 6 Po Krishti, si bir mbi shtëpin' e ti; shtëpia
 e të-cilit jemi neve, ndë mbajçimë shtrën-
 guarë kuximin' edhe të-mburrurit' e shpresë-
 së gjer ndë funt.
 7 Përandaj, sikundrë thotë Frym' e-Shënj-
 8 tëruarë, „Sot ndë dëgjofshi zën' e ati, Mos
 ashpëroni zëmëratë t'uaj si ndë pikëllimt, ndë
 9 ditët të ngasjesë ndë shkretëtirët; Ku atëritë
 t'uaj më nganë, më provuanë, edhe panë pu-
 10 nërat' e mia dy zet vjet. Përandaj uzëmëruashë
 me atë bres, edhe thashë, Përherë gënjenenë ndë
 zëmëret *të tyre*; edhe ata nuk' i njohnë udhët' e
 11 mia. Përandaj bëra be ndë zëmëratët t'ime,
 S'kanë për të hyrë ndë të-prëjturit t'm."
 12 Vështroni, o vëllezër, që të mos ketë as-
 ndonjë prej jush zëmërë të-ligë pabesërie, që
 13 të ngrerë krye kundrë Perëndis' së-gjallë; Po
 ngutni njëri jatërinë përdita, gjersa quhetë
dta „Sot“; që të mos ashpëronetë ndonjë prej
 14 jush me të-gënjyerit' e fajit. Sepse jemi bërë
 pjesëtarë të Krishtit, ndë mbajçimë shtrën-
 guarë të-nisurit' e të-besuarit gjer ndë funt;
 15 Kur thuhetë, „Sot, ndë dëgjofshi zën e ati,

mos ashpëroni zëmëratë t'uaj, si ndë pikë-llimt.“ Sepse ca veta, passi dëgjuanë, e pikëlluan' atë; po jo gjithë ata që dyallë prej E-17 gjyptësë me anë të Moisiut. Edhe me cilët' uzëmërua dyzet vjet a jo me ata që fëjyenë, të-cilëvet eshtërat' u ranë ndë shkretëtirët? 18 Edhe për cilëtë bëri be se nukë dotë hyninë ndë të-prëjturit t' ati, veç se për ata që 19 s'bindeshinë? Edhe shohëmë se për pabesërinë nukë murtnë të hynjënë.

Krye 4.

1 Letë kemi pra frikë, semos, gjersa mbetetë ndër ne të-zotuarë për të hyrë ndë të prëjturit t'ati, duketë ndonjë prej jush se mbetë ti jashtë. Sepse edhe neve jemi ungjillëzuarë, sikundrë edhe ata; po nuk'u bëri atyre dobi fjala që dëgjuanë, sepse s'qe bashkuarë 3 me besë mb'ata që e dëgjuanë. Sepse hyjmë ndë të prëjturit neve që besuamë, sikundrë ka thënë, „Përandaj bëra be ndë zëmëratët t'ime, S'kanë për të hyrë ndë të-prëjturit t'im;“ndonëse punërat' e ati umbaruanë që 4 kur se ungreh bota. Sepse ka thënë ndë një vënt për të-shtattënë ditë kështu: „Edhe uprëjt Perëndia mbë të-shtattënë ditë nga gjithë 5 punërat' e tia“. Edhe ndë këtë vënt përsëri „S'kanë për të hyrë ndë të-prëjturit t'im.“ 6 Passi ka mbeturë pra të hynjënë ca veta nd' atë, edhe ata që ungjillëzuanë më për-

7 para nukë hynë për të-pabindurit' e tyre, Përsëri ndan një ditë, „Sot,“ dyke thënë me anë të Dhavidhit, pas kaqë kohe; sikundrë është thënë „Sot ndë dëgjofshi zën' e ati, mos ashpëroni zëmëratë t'uaj.“ 8 Sepse po t'i kishte prëjtur' ata Jisuj i Navium, nukë dotë kishte folurë pastaj për një 9 tjetërë ditë. Mbetetë pra të-prëjturë për llauzin' e Perëndisë. 10 Sepse ay që hyri ndë të-prëjturit t'ati, edhe ay uprëjt nga punërat' e tia, sikundrë Perëndia nga të-tiatë. 11 Letë përpiqemi pra të hyjmë mb'ata të-prëjturë, që të mos bjerë ndonjë mb'atë shëmbëllesë të pabindjesë. Sepse fjal' e Perëndisë është e-gjallë, edhe e punësë, edhe më eprehëtë se çdo thikë me dy presje, edhe depërton gjer ndë të-ndarët të shpirtit edhe të frymësë, të nyjevet e të palcavet, edhe 13 çquan kujtimet' e mendimet' e zëmëresë. Edhe s'ka asndonjë kriesë që të mos jetë e-çfaqurë përpara ati, po të-gjiitha janë lakuriq edhe të-sbuluara ndë syt t'ati, të-cilit neve i kemi për të dhënë fjalë. 14 Dyke pasurë pra një kryepriift të-math që depërtoj qiejtë, Jisunë, të Birin' e Perëndisë, 15 letë mbajmë rrëfiminë t'ënë. Sepse s' kemi kryepriift që nukë munt t'i vinjë keq për dobësiiratë t'ona, po kryepriift që unga së-gji-

16 thash *posi ne*, përveç se nukë fëjeu. Letë a-fëronemi pra me kuxim ndë front të hirit, që të marrëmë përdëllim, edhe të gjejmë hir për ndihmë ndë kohët të nevojësë.

Krye 5.

- 1 Sepse çdo kryepriift që merretë prej njerësve, vihetë *kryepriift* për njerëzitë mbë punëratë që kanë të bënë me Perëndinë, që
- 2 të bjerë dhurata e kurbanë për fajë; Të-cilit munt t'i vinjë keq për ata që janë të-paditur' e të-gënjyerë; sepse edhe ay vetë
- 3 është veshurë me dobësirë. Edhe përandaj ka detyrë, sikundrë për llauzinë, kështu edhe për vetëhen' e ti, të bjerë *kurban* për fajë.
- 4 Edhe asndonjë nuk' e merr këtë nder prej vetëhes' së ti, po ay që thërritetë nga Perëndia, posi Aaroni. Kështu edhe Krishti nuk' e lavduroj vetëhen' e ti që të bënë të kryepriift, po ay që i foli, „Ti je Biri im, unë sot të
- 6 kam pjellë.“ Sikundrë edhe mbë tjetërë vënt thotë, „Ti je priift për gjithë jetënë pas regullës' së Melqisedhekut.
- 7 I-cili ndë ditt të mishit të ti, pasi pruri të-falura e të-lutura me klithmë të-fortë e me lot tek ay që muntte t'a shpëtonte atë nga vdekja, edhe udëgjua për të-druajturit'e
- 8 ti nga *Perëndia*, Ndonëse ishte bir, nxuri
- 9 nga ato që pësoj të jet' i-bindurë. Edhe si ubë i-sosurë, ubë ngajë për shpëtim të-për-

jetëshm mbë gjith' ata që i dëgjonjën' ati, 10 Dyke qën' i-quajturë nga Perëndia kryepriift 11 pas regullës' së Melqisedhekut. Për të-cilinë kemi të themi shumë punëra, të-cilatë nukë sgidhenë lehtë me fjalë; sepse jeni bërë të-rëndë nga veshëtë *për të dëgjuarë*.

- 12 Sepse, ndonëse sipas kohësë *që ka shkuarë* duhej të ishitë-mësonjës, përsëri keni nevojë t'u mësonjë juve ndonjë stiçiat' e-para të fjalëvet të Perëndisë; edhe keni arriturë të keni nevojë për qumësht, e jo për ushqim
- 13 të-shëndoshë. Sepse kushdo që ushqehetë me qumësht, është i-paprovuarshim ndë fjalët të
- 14 drejtërisë; sepse është foshnje. Po ushqimi i-fortë është për-*njerës* të-sosurë, të-cilëtë me-qënë-që janë mësuarë kështu, i kanë ndjenjat' e tyre të-stërçitura për të çquarë të-mirën' e të-ligënë.

Krye 6.

- 1 Përandaj si të lëmë kryet' e mësimit të Krishtit, letë bihemi mbë të-mbaruarët, pa vënë përsëri themeli pendimi prej punërash
- 2 të-vdekura, e besë mbë Perëndinë, Mësimi për pagëzime, e të të-vënurit të duarvet, e të të-ngjallurit të të-vdekurvet, e të gjyqit të-
- 3 përjetëshm. Edhe këtë dot'a bëjmë, ndë dhën-
- 4 të lejë Perëndia; Sepse është punë që s'bënetë ata që undriçuanë një herë, edhe ndjenë shijën' e dhurëtisë qiellore. edhe ubënë pje-

- 5 shtarë të Frymës' së-Shënjtëruarë, Edhe ndjenë shijën' e fjalës' së-mirë të Perëndisë, edhe
- 6 të fuqivet të jetës' së-pritme, Edhe pastaj urrëzuanë, të përtërihenë përsëri ndë pendim; sepse kryqëzonjënë përsëri ndë vetëhet të tyre të Birin' e Perëndisë, edhe e turpëronjënë.
- 7 Sepse dheu që pi shinë që bje shumë herë mbi atë, edhe pjell barëra të-dobishime për ata, për të-cilatë edhe punonetë, merr
- 8 bekim nga Perëndia. Po ndë nxjertë gjëmba e murriza, *ësh'* i-paprovuarshim edhe afërë mallëkimit, fundi i të-cilit ëshë të digjetë.
- 9 Po për ju, o të-dashurë, ndonëse flasëmë kështu, na është mbushurë mëndja, se *keni* më të-miratë gjërëra, të-cilatë janë bashkuarë me shpëtimnë. Sepse Perëndia nuk' është i-shtrëmbërë, që të harronjë punënë t'uaj, edhe mundimin' e dashurisë që dëftyetë mb'emërin' e ati me shërbesënë që u bëtë e po
- 11 u bëni shënjtorevét. Edhe dëshërojmë që gjithësicili prej jush të dëftenjë gjithatë kujdes për të-vërtetuarët'e-plotë të shpresës
- 12 së gjer ndë funt; Që të mos bëni të-përtuarshim, po të bëni si'ata që trashëgonjënë të-zotuaratë me anë të besës' e të zëmërës' së-gjerë.
- 13 Sepse Perëndia, kur i uzotua Avraamit pasi s'kishtë asndonjë më të-math, mbë të-cilinë të bënte be, bëri be mbë vetëhen' e ti,

- 14 Dyke thënë, „Vërtet dyke bekuarë dotë të bekonj, edhe dyke shumuarë dotë të shu-
- 15 monj.“ Edhe kështu *Avraami*, dyke priturë
- 16 me durim, fitoj të-zotuarëtë. Sepse njerëzitë bëjnë be mbë më të-madhinë, edhe beja mbë
- 17 ata është fundi i çdo kundrëfoljeje për të-vërtetuarë. Kështu Perëndia, dyke dashurë të dëftenjë më tepërë mbë trashëgimtarët' e të-zotuarit' të-pakthyerit' e ëndës' së ti, vuri
- 18 ndërmjetës benë, Që me anë dy gjërërave të-pakthyershime, ndë të-cilat është pun' e-pamundurë të gënjenjë Perëndia, të kemi ngushullim të-fortë neve që usulmë që të mbajmë
- 19 shpresënë që kemi përpara; Të-cilinë e kemi posi angurë të-shpirtit të-siguruarë e të-vërtetuarë, edhe që hyn mbë të-përbrëndëshmet
- 20 të kurtinësë; Atje ku Krishtit hyri për ne e na hapi udhënë, pasi ubë kryeprift pas regullës, së Melqisedhekut.

Krye 7.

- 1 Sepse ky Melqisedheku, mbreti i Salimit, prift i fort të-lartit Perëndi, i-cili upoq me Avraaminë, kur kthenej prej të-gririt të mbretërvet, edhe e bekoj; Të-cilit Avraami i ndau edhe të-dhjetë nga gjithë *plaçkatë*, (i-cili më përpara përkthenetë mbret drejtërie, edhe pastaj edhe mbret i Salimit, që do me thënë
- 3 mbret paqtimi,) Pa atë, pa mëmë, pa gjenealogji, pa pasurë as të nisurë ditsh, as funt

- jete, po i-përgjajturë me Birin' e Perëndisë, mbetetë prift për gjithënjë.
- 4 Pa mendohuni sa i-math *ishte* ky, të-cilit Avraami kryeati i dha edhe të-dhjettë nga
- 5 plaçkatë. Edhe nga të bijt'e Leviut ata që marrënë priftërinë, kanë porosi të marrënë pas
- nomit të-dhjettë nga llauzi, do-me-thënë nga vëllezërit' e tyre, ndonëse kanë dalë nga mezi
- 6 i Avraamit; Po ay që nuk' e kishte gjenea-llogjinë nga ata mori të-dhjettë nga Avraami,
- 7 edhe bekoj atë që kishte të-zotuaratë. Edhe pa ndonjë kundrëfjalë m'i-vogëli bekonetë nga m'i-madhi.
- 8 Edhe këtu njerës të-morçim marrënë të-dhjetta ;po atje *merr të-dhjetta* 'ay që dëshmo-
- 9 netë se rron. Edhe që të them kështu, me anë të Avraamit edhe Leviu, që merr të-
- 10 dhjetta, dha të-dhjetta. Sepse ishte edhe ndë mest të t'et, kur upoq me atë Melqisedheku.
- 11 Po të ishtë pra të-mbaruarëtë me anë të priftërisë Levitike, (sepse llauzi mbi atë mori nomnë), ç'nevojë më ishte të ngrihetë tjetërë prift pas regullës' së Melqisedhekut, e të mos thuhetë pas regullës' s' Aaronit?
- 12 Sepse kur ndërronetë priftëria, prej nevoje
- 13 bënetë edhe ndërrim nomi. Sepse ay, për të-cilinë thuhetë këto, ishte prej tjetërë fare, prej së-cilësë asndonjë s'i qe afëruarë theoresë.
- 14 Sepse është gjë e-çfaqurë, se Zoti ynë lindi nga Judha, mbë të-cilënë farë asgjë për prif-

- 15 tëri nukë foli Moisiu. Po edhe shumë më tepërë është'e-çfaqurë, sepse pas shëmbëllimit
- 16 të Melqisedhekut ngrihetë tjetërë prift, I-cili nuk'ubë pas nomit të porosis' së mishit, po
- 17 pas fuqis' së jetësë që s'ka funt. Sepse dëshmon, dyke thënë, „Se ti je prift për gjithë jetënë pas regullës' së Melqisedhekut.“
- 18 Sepse porosia e-parë bje poshtë, kur është
- 19 e-dobëtë edhe e-padobishime; (Sepse nomi nukë mbaroj asndonjë farë pune;) po kalli një shpresë më të-mirë, më anë të së-cilësë i afëronemi Perëndisë.
- 20 Edhe me-qënë-që nuk' *ubë prift* pa të-bërë
- 21 be; (Sepse ata qenë bërë priftër pa të-bërë be, po ky me të-bërë be, m'anë të ati që i tha ati, „Zoti bëri be, edhe nukë dotë pendonetë, Ti je prift për gjithë jetënë pas regullës' së Melqisedhekut;“) Kaqë i *njëj* dhjate më së-lartë ubë dorëzënës Jisuj.
- 23 Edhe ata qenë bërë priftër më shumë se *një*, sepse ndaloneshinë prej vdekjesë të mbe-
- 24 tenë për gjithënjë; Po ky, pasi mbetetë për gjithë jetënë, ka priftërinë të-pandërru-
- 25 arshime. Përandaj edhe munt t'i shpëtonjë fare ata që afëronenë përanë Perëndisë me anë t'ati, sepse gjithënjë rron që të lajmësonjë për ata.
- 26 Sepse i-këtille kryeprift duhej pëj ne, shënjt, i-pafajm, i-pazhyerë, i-ndarë veç nga
- 27 fajtorëtëe, edh i-bërë më i-lartë se qiejtë; I-

cili nukë ka përdita nevojë, si ata kryepriftëritë, të bjerë kurbanë më përpara për fajet' e ti, edhe pastaj për ata të llauzit; sepse këtë e bëri një herë, kur pruri *kurban* vetëhen' e ti.

28 Sepse nomi vë kryepriftër njerës që kanë dobësirë; po fjala e të bërit be që ubë pastaj nomit *vuri* Birinë, i-cili është i-mbaruarë për gjithë jetënë.

Krye 8.

- 1 Edhe përmbledhja e atyreve që themi është *këjo*, Kemi një të-tillë kryeprift, i-cili ndënjë ndë të-djathtët të fronit të madhërisë ndë
- 2 qiejt, edhe është shërbëtuat i shënjtëroresë, edhe i tendës' së-vërtetë të-cilën'e nguli Zoti, e jo njeri.
- 3 Sepse çdo kryeprift vihetë që të bjerë dhurëtira e kurbanë; përanda *është* nevojë
- 4 të ketë edhe ky diç që t'a bjerë kurban. Sepse ndë ishte mbi dhet, nukë dot' ishe prift, sepse janë priftëritë që bjenë dhurëtiratë pas
- 5 nomit; Të-cilëtë punonjënë pas shëmbëllës' edhe pas hies' së qiellorevet, sikundrë i qe folurë Moisiut, kur kishte për të ndërtuarë tendënë; sepse „Shiko,“ thotë, „t'i bënjç të-gjitha pas formësë që t'udëftue tyj ndë malt.“
- 6 Po ndasti Krishti mori një shërbesë kaqë më të-çquarë, sa është edhe lajmës i një dhjate më së-mirë, e-cila ubë nom përmbi të-zotuara më të-mira.

- 7 Sepse ndë ishte pa palavi ajo e-para, nu-
- 8 kë dotë kërkonej vënt për të-dytënë. Sepse *Perëndia* dyke qërtuarë ata thotë, „Ja tek po vijnë dit, thotë Zoti, edhe dotë bënj një dhjatë të-re me shtëpin'e Israilit edhe me shtë-
- 9 pin' e Judhësë; Jo pas dhjatës' që bëra me atërit' e atyre atë ditë që i rroka ata prej dore, që t'i nxirnam ata prej dheut të Eqjiptësë; sepse ata nukë qëndruanë ndë dhjatët t'ime, edhe unë s'i vura re ata, thotë Zo-
- 10 ti. Sepse këjo është dhjata që dotë bënj me shtëpin'e Israilit pas atyre ditve, thotë Zoti, Dotë vë nomet' e mi ndë mëndjet t' atyre, edhe dot' i skruanj ata mbi zëmërat t' atyre, edhe dotë jem tek ata për Perëndi, e-
- 11 dhe ata dotë më jënë për llaus. Edhe nukë dotë mësonjënë gjithësicili të-afërmin' e ti, edhe gjithësicili vëllan' e ti, dyke thënë, Njih Zotinë; sepse të gjithë dotë më njohënë, që prej të-vogëlit t' atyre e gjer mbë të-madhin'
- 12 e atyre. Sepse dotë jem i-përdëllyershim mbë paudhërit' e atyreve, edhe nukë dotë kujtonj më fajet' e atyreve edhe panomit' e atyreve.“
- 13 Dyke thënë „të-re,“ e vjetëroj të-parënë; edhe ajo që vjetëronet'e mblaketë është afërrë prishjesë.

Krye 9.

- 1 Kishte pra edhe tenda e-parë urdhëre lu-2 tjeje, edhe sënjtërorenë prej kësaj bote; Se-

- pse undërtua tend' e-parë, ndë të-cilët ishte edhe kandileri, edhe truveza, edhe parëvënja
- 3 dhe bukëvet, e-cila *tendë* thuhetë Shënjtërore. E-dhe pas kurtinës' së-dytë *ishte* tenda që thuhetë
- 4 hetë Shënjtërore e Shëntërorevet, E-cila kishte një tymtore të-artë, edhe arkën' e dhjatësë të-mbuluarë rreth nga të-gjithë anëtë me ar, ndë të-cilët ishte shtëmba e-artë që kishte mannënë, edhe shkopi i Aaronit që biu, edhe
- 5 dërrasat' e dhjatësë; Edhe pësipër' asaj ishinë Qeruvimet' e lavdisë që i lëshoninë hie fronit të përdëllimit; për të-cilatë nuk' është ndashti nevojë të themi hollë hollë.
- 6 Edhe tek ishinë këto ndëtuarë kështu, ndë të-parët tendë gjithënjë hynjënë priftëritë që
- 7 bënënjë lutjetë; Po ndë të-dytët një herë ndë vitt *hyn* vetëmë kryeprifti, jo pa gjak, të-cilin' e bje *kurban* për vetëhen' e ti edhe për fa-
- 8 jet' e llauzit që i bënënjë nga paditja; Edhe këtë e dëftente Frym' e-Shënjtëruarë, se edhe s'ishte çfaqurë udha mbë Shënjtëroren' e Shënjtërorëvet, sepse tend' e-parë edhe po
- 9 qëndronte; E-cila ishte formë për kohën' e atëhershime, kur bininë dhurëtira e kurbanë, të-cilatë nukë muntninë t'a bëninë të-sosurë
- 10 nga dërgjegja atë që lutej, Sepse ishinë urdhëruarë vetëmë për të-ngrëna e për të-pira e për ç' do farë të-larash, e për urdhëre mishi, gjer mbë kohët të të-ndrequrit.
- 11 Po si erdhi Krishi, kryeprifti i të-miravet

- që kanë për të ardhurë me anë të më sëmadhes' e më së-mbaruarësë tendë, që s'është bërë me dorë, do-me-thënë, që s'është prej
- 12 kësaj kriese, As me anë gjaku cjespsh e viçash, po me anë të gjakut të ti hyri një herë ndë Shënjtëroret të *Shënjtërorëvet*, edhe
- 13 fitoj çpërblim të-përjetëshm. Sepse ndë qoftë se gjaku i demavet e i cjepvet, edhe hiri i mëshqerësë që përskat të-pëgërëttë, shënjtëron për pastrimin' e mishit, Sa më tepërë gjaku i Krishtit, i-cili me anë të Frymës' së-përjetëshme pruri vetëhen' e ti për *kurban* pa palavi te Perëndia, dotë pastronjë ndërgjegjenë t' uaj nga punëra të-vdekura, që të lusni Perëndin' e-gjallë?
- 15 Edhe përandaj është mestar i një dhjatë së-re, që, me anë të vdekjesë që ubë për çpërblimin' e të-shkelurit të porosivet ndë kohët të dhjatës' së-parë, të marrënë ata që janë thërriturë të-zotuarët' e trashëgimit të-përjetëshm. Sepse atje ku ka dhjatë është nevojë të ketë vdekje t' atë që bëri dhjatënë;
- 17 Sepse dhjata ka fuqi mb' ata që kanë vdekurë; sepsë kurrë s'ka fuqi gjersa rron ay që bëri dhjatënë. Përandaj as e-para nukë qe vërtetuarë
- 18 rë pa gjak; Sepse passi ufol prej Moisiut çdo porosi pas nomit mbë gjithë llauzinë, mori gjakun' e viçërvet e të cjepvet, bashkë me ujë e me lesh të-kuq e me hyssop, e për-
- 20 skati edhe atë vivlinë e gjithë llauzinë, Dyke

- thënë, „Ky është gjaku i dhjatësë, që urdhë-
 21 roj Perëndia mbë ju.“ Edhe gjithashtu për-
 skati me gjak edhe tendën' edhe gjith' enët'
 22 e shërbesësë. Edhe po-thua me gjak të-gjitha
 qëronenë pas nomit, edhe pa derdhurë gjak
 s'ka ndjesë *fajesh*.
- 23 Ishte nevojë pra format' e qiellorevet të
 qëronenë me këta, po qielloretë me kurbanë
 24 më të-mirë se këta. Sepse Krishti nukë hyri
 ndë shënjtërore të-bëra me dorë, që janë
 kundrëforma të të-vërtetavet, po ndë qiellt
 vetë, që të duketë ndashti përpara Perëndisë
 25 për ne; As të bjerë *kurban* vetëhen' e ti shu-
 më herë, sikundrë kryeprifti hyn ndë shënjtë-
 26 roret vit për vit me gjak të-huaj; (Sepse a-
 tëhere duhej shumë herë të pësonte qëkur
 se ufillua bota;) po ndashti një herë ndë
 funtt të jetëvet uçfaq, që të prishnjë fajinë
 27 me anë të kurbanit të vetëhes' së ti. Edhe
 sikundrë është urdhëruarë për njerëzitë një
 herë të vdesënë, edhe pastaj është gjyqi;
 28 Kështu edhe Krishti, passi një herë upru
kurban që të ngrerë fajet' e shumëve, dotë
 duketë për-së-dyti pa faj ndër ata që e pre-
 sënë për shpëtim.

Krye 10.

- 1 Sepse nomi, dyke pasurë një hie të të-
 miravet që kishinë për të ardhurë e jo atë
 figurën' e gjërëravet, s' munt kurrë me anë

- të gjithatyre kurbanëve, që bjenë vit për vit
 përherë, të bënë të-sosurë ata që afëronenë.
 2 Sepse atëhere dotë kishinë pushuarë së pruri
 kurbanë, sepse lutësitë, si të qëroneshinë një
 herë, nukë dotë kishinë më asdonjë ndërgje-
 3 gje fajesh. Po nd' ata *bënetë* kujtim fajesh
 4 vit per vit. Sepse është *gjë* e-pamundurë gjak
 5 demash e cjepsh të heqnjë faje. Përandaj,
 dyke hyrë ndë botët, thotë, „Kurban e dhu-
 ratë nukë deshe, po bëre gati për mua trup.
 6 *Kurbanë* të-gjithëdjegurë edhe të-*prura* për
 7 faj nukë pëlqeve. Atëhere thashë, Na tek po
 vinj, (ndë ballët të vivlisë është shkruarë
 për mua,) për të bërë, o Perëndi, dashurimnë
 8 t'ënt.“ Passi tha më sipërë, “Se kurban edhe
 dhuratë, edhë të-gjithëdjegura edhe të-*prura*
 për faj nukë deshe, as nuk' i pëlqeve,„ (të-
 9 cilatë bihenë pas nomit,) Atëhere tha, “Na
 tek po vinj, për të bërë, o Perëndi, dashu-
 rimnë t' ënt,„ Heth tej të-parënë, që të qën-
 10 dronjë të-dytënë. Prej këti dashurimi jemi
 shënjtëruarë me anë të të-prurit kurban të
 trupit të Jisu Krishtit që *ubë kurban* një herë
 për *gjithë*.
- 11 Edhe çdo prift rri përdita dyke shërbyerë,
 edhe bje shumë herë gjithata kurbanë, të-
 cilatë kurrë nukë muntnjënë të heqënë faje.
 12 Po ay, passi prurri një kurban për faje, ndë-
 nji për gjithënjë ndë të-djathtët të Perëndisë,
 13 Dyke priturë paskëtaj giersa të vihenë ar-

- miqt' e ati ndënëkëmbjë të këmbëvet t' ati.
- 14 Sepse me një dhuratë bëri të-sosurë për gjithënjë ata që shënjtëronenë.
- 15 Po edhe Frym' e-Shënjtëruarë dëshmon mbë ne; sepse passi pat thënë më përpara,
- 16 "Këjo është dhjata që dotë bënj mb' ata pas atyre ditve, thotë Zoti, dotë vë nomet' e mi ndë zëmërat t' atyreve, edhe dot' i shkruanj
- 17 ata ndë mëndjet t' atyreve., *Shtoj*, "Edhe fajet' e atyreve edhe paudhërit' e atyreve nukë
- 18 dot' i kujtonj më., Edhe ku ka ndjesë të këtyreve, nukë ka më dhuratë për faj.
- 19 Dyke pasurë pra, o vëllezër, sy të hyjmë ndë shënjtëroret me anë të gjakut të
- 20 Jisujt, Me anë një udhe së-re edhe së-gjallë, të-cilënë e hapi për ne me anë të kurtinësë,
- 21 do-me-thënë, të mishit të ti, Edhe *dyke pasurë* një prift të-math mbi shtëpit të Perëndise,
- 22 Let' afëronemi me zëmërë të-vërtetë e me besë të-mbaruarë, dyke pasurë zëmëratë t' ona të-qëruara prej ndërgjegjeje së-ligë;
- 23 Edhe, dyke pasurë trupinë të-larë me ujë të-kulluarë, letë mbajmë rrëfimin' e shpresësë të-patundurë; sepse besëtar është' ay që u-
- 24 zotua; Edhe letë kujdesemi njëri për tjetërinë, dyke nguturë ndë dashuri e ndë punëra
- 25 të-mira; Edhe letë mos lëmë të-mbledhuritë t' anë bashkë, sikundrë është zakon mbë ca *veta*, po të ngutimë njëri tjetërinë; edhe kaqë më tepërë, sa shihni ditënë që po afëronetë.

- 26 Sepse ndë fëjefshimë neve dyke dashurë, passi muarmë të-njohurit' e së-vërtetësë, nukë
- 27 mbetetë më kurban për faje; Po një të-priurë gjyqi të-frikshim, edhe *një* të-ndezurë zjarri, i-cili ka për të ngrënë ata që janë
- 28 kundrë. Ndë shkeltë ndonjë nomin' e Moisu-ut, pa përdëllim përpara dy a tre dëshmim-
- 29 tarëve vritetë; Sa më të-keq mundim, u duketë juve, se dotë heqë ay që ka shkelurë me këmbë të Birin'e Perëndisë, edhe e ka numëruarë *si gjë* të-pëgërë gjakun' e dhjatësë, me të-cilinë ushënjtërua, edhe ka sharë frymën'
- 30 e hirit? Sepse e dimë atë qe ka thënë, "Çpagemi *eshte* imi, unë kam për të çpaguearë, thotë Zoti. Edhe përsëri, "Zoti dotë gjykonjë
- 31 llauzin' e ti., *Pun'* e-frikshime ështëë të bjerë njeriu ndër duart të Perëndis' së-gjallë.
- 32 Bini ndër mëntt *ato* ditt' e-para, ndë të-cilat, passi undriquatë, duruatë të-madhe
- 33 luftë të-hequrash; Kur, dyke ubërë lodrëti *prej botësë* me të-shara e me shtrëngime; kur, dyke ubërë pjesëtarë t' atyreve që pesonjënë të
- 34 këtillatë. Sepse treguatë dhëmbje *për mua* ndë të-lidhurat të mia, edhe të-rrëmbyerët' e kamjesë s' uaj e prittë më gëzim, dyke diturë, se keni për vetëhenë t' uaj ndë qiejt
- 35 një pasje më-të-mirë e të-qëndruarshime. Mos e humpni pra kuximinë t' uaj që ka për të dhënë çpagem të-math.
- 36 Sepse ju keni nevojë për durim, që të

bëni dashurimn' e Perëndisë, edhe të merrni
 37 të-zotuarëtë. „Sepse edhe fort pakëzë kohë,
 edhe dotë vinjë ay që vjen, edhe nukë dotë
 38 mënonjë.„ “Edhe i-drëjti dotë rronjë prej besësë;„ edhe “ndë uheqtë *ndonjë* prapa, shpirti
 39 im nukë gjen pëlqim mb' atë.„ Po neve nukë
 jemi nga ata që hiqenë prapa për humbje,
 po nga ata që besonjë për shpëtim të-
 shpirtit.

Krye 11.

- 1 Edhe besa është të-qënurë të gjërërave që shpërehenë, dëftesë punërave që nukë shihenë.
- 2 Sepse me anë të kësaj muarnë dëshmim të-*mirë* të-moçimitë.
- 3 Me anë të besësë kupëtojmë se jetët' u-ndërtuanë me fjalën'e Perëndisë, kaqë sa ato që shihenë nuk' ubënë prej *gjërërave* që dukenë.
- 4 Me anë të besësë Abeli i pruri Perëndisë më të mirë kurban se Kaini, me anë të sëcilësë mori dëshmim se ishte i-drejtë, sepse Perëndia dha dëshmim për dhuratat' e ati; edhe me anë t' asaj, ndonëse vdiq, edhe po flet.
- 5 Me anë të besësë Enohu undërrua vëndit, që të mos shohë vdekje, “edhe nukë gjëndeje, sepse Perëndia e ndërroj vëndit;„ sepse më përpara se të ndërrohej vëndit kishte dëshmim,

- 6 se i kishte pëlqyerë Perëndisë. Edhe pa besë është pun' e-pamundurë t' i pëlqenjë *njeriu* ati; sepsë ay që afëronetë te Perëndia duhetë të besonjë, se është, edhe se bënë pagë-dhënës mb' ata që e kërkonjë atë.
- 7 Me anë të besësë i udëftye Noesë nga Perëndia për ato *punëra* që edhe nukë shiheshinë, edhe si ufrikësua, ndërtoj një arkë për shpëtim të shtëpis' së ti; me anë te sëcilësë dënoj botënë, edhe ubë trashëgimtar i drejtërisë që është me anë të besësë.
- 8 Me anë të besësë ubint Avraami, kur uthërrit të dalë mb' atë vënt, të-cilinë kishte për të marrë për trashëgim, edhe dolli pa diturë se ku vete. Me anë të besësë vate e ndënji ndë dhet të të-zotuarit si *mbë një* dhe të-huaj, edhe ndënji ndë tenda, bashkë me Isaakun' e me Jakovinë bashkëtrashëgimtarët'
- 10 e gjithati të-zotuari; Sepse priste qytetinë që kishte themelitetë, mjeshtëtër edhe ndërtestar i të-cilit është Perëndia.
- 11 Me anë të besësë edhe ajo Sarra mori fuqi të bënë me barrë, edhe, ndonëse i kishte shkuarë koha e moshësë, polli, sepse
- 12 e numëroj të besësë atë që i uzotua. Përandaj edhe prej njëj *njeriu*, edhe këtij gati për të vdekurë, lintë *kaqë shumë njerës* sa yjt' e qiellit nga shumica, edhe posi rëra e-pa-numëruarë që është ndë buzët të detit.
- 13 Këta të-gjithë vdiqnë më besë, pa marrë

- të-zotuaratë, po i panë ato për-së-largu, (edhe uvërtetuanë për ato,) edhe i përshëndoshnë ato, edhe rrëfyanë së janë të-huaj edhe t' ardhurë mbi dhet. Sepse ata që flasënë të-
 14 këtilla, dëftenjënë se kërkonjënë atdhe. Edhe ndë e mbaninë mënt atë atdhe, prej të-cilit patnë dalë, dotë gjeninë kohë të ktheneshinë
 16 atjë. Po ndashti dëshëronjënë një atdhe më të-mirë, do-me-thënë, qielluar; përëndaj Perëndisë nuk' i vjen turp të quhetë Perëndi i atyreve; sepse bëri gati për ata qytet.
- 17 Me anë të besësë Avraami, kur provonej, pruri Isakunë për kurban; edhe ay që pat priturë të-zotuaratë pruri për kurban birin' e
 18 ti të-vetëmlindurinë, Mbë të-cilinë qe folurë „Se mbë Isaakunë dotë quhetë fara jote;“
 19 Dyke menduarë, se Perëndia munt të ngjallnjë edhe prej së-vdekurish; prej të-cilëvet edhe e mori atë prapë me të-përgjajturë.
- 20 Me anë të besësë Isaaku bekoj Jakovin' edhe Isafinë për punëratë që kishinë për të-ardhurë.
- 21 Me anë të besësë Jakovi dyke vdekurë bekoj sicilin' e bijvet të Josifit, „edhe ufal dyke pshteturë mbi majët të shkopit të ti.“
 22 Me anë të besësë Josifi dyke vdekurë përmëndi për të-dalët' e bijvet të Israilit nga Egjypta, edhe porositi për eshtërat' e tia.
- 23 Me anë të besësë Moisiu, si lindi, ufsheh tre muaj prej prindërvet të ti, sepse panë se

- çuni ishte i-bukurë; edhe nuk' utrëmpnë nga
 24 urdhëri i mbretit. Me anë të besësë Moisiu, si ubë i-math, mohoj të thuhetë i bir' i së
 25 bijës' së Faraonit; Sepse sgjodhi më tepërë të heqë keq bashkë me llauzin' e Perëndisë,
 26 se të ketë dëfrim faji për pakëzë kohë; Dyke numëruarë dhunën e Krishtit për më të-madhe pasje se thesarëtë ndë Egjyptë; sepse
 27 shikonte ndë çpagimt. Me anë të besësë la Egjypnë pa pasurë frikë për zëmëratën' e mbretit; sepse qëndroj posi dyke parë të-
 28 padukurinë. Me anë të besësë bëri pashkënë edhe të-përskaturit' e gjakut, që të mos i ngiste ata ay që prishte të-parëllinduritë.
- 29 Me anë të besësë shkuanë ndëpër Dett të-Kuq posi ndëpër tokë; të-cilinë kur e provuanë Egjyptianëtë, umbytnë.
- 30 Me anë të besësë ranë muret' e Jerihosë, si uqerthëlluanë shtatë herë.
- 31 Me anë të besësë kurva Rahabë nukë humbi bashkë me ata që s' bindeshinë, passi priti përgjonjësitë me paqtim.
- 32 Edhe ç' të them më? Sepse nukë dotë më arrinjë koha të tregonj për Gjedheoninë, e për Barakunë, e për Sampsoninë, e për Jefthaenë, për Dhavidhinë e për Samuilin' e për
 33 profitëritë; Të-cilëtë me anë të besësë muntë mbretërirë, punuanë drejtëri, fituanë të-zotuaratë, thurnë gojë leonësh, Shuanë fuqin' e
 34 zjarrit, shpëtuanë nga gojëjt' e thikësë, muarnë

- fuqi nga dobësiatë, ubënë të-fortë ndë luf-
 35 të, thyenë ushtërirat' e të-hujvet; Gra mu-
 arnë të-vdekuri' e tyre të-ngjallurë; e të-tjerë
 umunduanë, sepse nukë pritnë shpëtiminë,
 36 që të fitoninë *një* të-ngjallurë më të-mirë; E
 të-tjerë uprovuanë me të-përqeshura e me
 të-rrahura, po edhe me të-lidhura e me burk;
 37 Uvranë me gurë, usharruanë, unganë, vdiqnë
 prerë prej thike; vininë vënde mbë vënde
veshurë me lëkurë dhësh, e me lëkurë dhish,
 dyke pasurë nevojë, dyke pasurë shtrëngime,
 38 dyke hequrë keq, (*Ata* për të-cilëtë bota nuk'
 ishte e-vëjyërë;) dyke shkuar' andej e këtej
 ndëpër shkretëtira e ndëpër male e ndëpër
 shpella e ndëpër vërat të dheut.
 39 Edhe këta të-gjithë, ndonëse muarnë dësh-
 mim *të-mirë* me anë të besësë, nukë muarnë
 40 të-zotuarëtë; Sepse Perëndia pat urdhëruarë
 që përpara një gjë më të-mirë për ne, që të
 mos bënenë të-sosurë pa neve.

Krye 12.

- 1 Andaj edhe neve, rrethuarë prej një kaqë
së-madhe reje dëshmimtarësh, letë hethmë
 tej çho barrë edhe fajinë që *na* pushton
kaqë lehtë, edhe me durim letë sulemi ndë
 2 udhët që është përpara nesh, Dyke shiku-
 arë mbë Jisunë që *është* kryet' edhe fundi i be-
 sësë, i-cili përgëziminë që ishte përpara ati du-
 roj kryqnë, pa zënë për gjë turpienë, edhe

- ndënji ndë të-djathtët të fronit të Perëndisë.
 3 Sepse kujtoni atë që duroj prej fajtorë-
 vet të-këtitillë kundrëfolje mbë vetëhen'e ti,
 që të mos lodhi dyke udobëtuarë ndë shpir-
 tërat t'uaj.
 4 Ju edhe s'keni qëndruarë gjer mbë gjak.,
 5 dyke luftuarë kundrë fajit; Edhe keni harru-
 arë këshillenë, që posi bijve u flet juve,
dyke thënë, "Biri im, mos hith tej mundi-
 min'e Zotit; mos e hump zëmërenë, kur qërto-
 6 nesh prej ati. Sepse atë që do Zoti e mun-
 don, edhe rreh çdo bir që pret për anë vetë-
 7 hesë., Ndë durofshi mundiminë, Perëndia si-
 lletë mbë ju, posi mbë bij; sepse cili është
 8 ay bir që s'e mundon i ati? Po ndë jeni pa
 mundim, mbë të-cilinë ubënë pjesëtarë të-gji-
 9 thë, atëhere jeni doçër, e jo bij. Pastaj atë-
 ritë t'anë pas mishit i kishimë mundonjës, e-
 dhe i nderonim'ata; a nukë dot'i unjmë kryetë
 shumë më tepërë Atit të frymavet, edhe të
 10 rrojmë? Sepse ata *na* mundoninë për pak
 dit, sipas pëlqimit të tyre; po ay për të-mi-
 rënë t' *ënë*, që të bënëmi pjesëtarë të shënj-
 11 tëris' s'ati. Edhe çdo mundim ndashti nukë
 duketë se bje gëzim, po hidhërim; po pas-
 taj u ep pemë paqtimi prej drejtërie atyreve
 12 që janë stërviturë me anë t'ati. „Për andaj
 forconi duart' e-dobëtuara edhe gjunjët' e-kë-
 13 puturë., „Edhe“ bën-u-ni këmbëvet t' uaj udhë
 të-drejta., që të mos dalë jashtë udhësë ajo që

- është e-çalë, po më tepërë të shëronetë.
- 14 Kërkoni paqtim me të-gjihtë, edhe shënj-tëriminë, pa te-cilinë asndonjë nukë ka për
- 15 të parë Zotinë; Dyke vënë re semos mbetetë ndonjë i-shterurë nga hiri i Perëndisë; "semos mbinjë ndonjë rrënj' e-hidhurë, e u trumbullon,, edhe me anë të kësaj ndyrenë shumë
- 16 vëta; Se mos ndodhetë ndonjë kurvar e i-ndyrë si Isafi, që shiti parëlindjët' e ti për një
- 17 gjellë. Sepse e dini, se edhe pastaj, kur desh i të trashëgonjë bekimnë, uhoth tej; sepse nukë gjeti vënt pendimí, ndonëse e kërkoj me lot.
- 18 Sepse nukë jeni afëruarë ndë mal që zihetë me dorë, e që digjetë me zjarr, edhe mbë vrërsirë, e mbë errërsirë, e mbë thë-
- 19 llim, E mbë zë trumbete, e mbë zë fjalësh, të-cilin' ata që e dëgjuanë ulutnë të mos u
- 20 flitej më fjala atyreve; (Sepse nukë *muntninë të duroninë urdhërinë*, që "Edhe shtëzë ndë i pjektë malit, dotë vritetë me gurë, a
- 21 dotë shëgjetonetë me shëgjetë;,, Edhe kaqë të-frikshim ishte të-dukuritë, sa Moisiu tha,
- 22 Jam fort i-frikësuarë edhe i-trëmburë;) Po uafëruatë ndë malt Sion, edhe ndë qytett të Perëndis' së-gjallë, ndë qjelloret Jeruslime,
- 23 edhe ndë shumë mijëra ëngjëjsh, Ndë mbledhjet e ndë kishët të të-parëlindurëvet, të-cilët janë shkruarë ndë qiejt, edhe te Perëndia, gjykatësi i të-gjihtëve, edhe te shpirtë-

- rat' e të-drejtëvet që janë bërë të-sosurë,
- 24 Edhe te mestari i dhjatës' së-re Jisu, edhe ndë gjakt të të-përskaturit, që flet më mirë se ay i Abelit.
- 25 Shikoni semos hiqni dorë nga ay që flet; sepse ndë mos shpëtuanë ata që hoqnë dorë nga ay që fliste *tek ata* mbi dhet, shumë më tepërë *nukë dotë sdpëtojmë* neve, ndë i kthefshimë krahëtë ati *që flet* prej qiejvet;
- 26 Zër' i të-cilit atëhere tundi dhenë; po ndashti uzotua, dyke thënë, "Unë edhe një herë dotë
- 27 tunt jo vetëmë dhenë, po edhe qiellinë,, Edhe këjo *fjalë* "Edhe një herë,, dëften të-ndërruarët' e vëndit t' atyreve që tundenë,
- 28 posi të-bëra *me dorë*, që të mbetenë ato që nukë tundenë. Përandaj passi marrëmë një mbretëri të-patundurë, letë mbajmë hirinë, me anë të të-cilit pëlqyershim t' adhurojmë
- 29 Perëndinë, me nder e me të-druajturë. Sepse "Perendia ynë *është* zjarr që tret.,

Krye 13.

- 1 Dashuria e vëllazërisë letë mbesë; (2) Mos harroni dashurinë mbë të-huajtë; sepse me anë të kësaj ca pa diturë pritnë ëngjëj ndë
- 3 shtëpit të tyre. Kujtoni te-lidhuritë, si të-lidhurë bashkë me ata; ata që heqënë keq, sikurse jeni edhe vetë ndë trupt t' atyre.
- 4 Martesa letë jet' e-nderçime ndër të-gjihtë, edhe shtrati i-paturpëruarë; sepse kur-

- varët' e pëgërësitë dot' i gjykonjë Perëndia.
- 5 Të-sjellatë t' uaj *letë jenë* pa lakmim ergjëndi; let' u jenë mjaft ato që keni ndashti; sepse ay ka thënë, "Nuk të kam për të lënë, as nukë kam për të hequrë dorë prej teje;,"
- 6 Përandaj neve me kuxim letë themi, "Zoti është ndihmësi im, edhe nukë dotë kem frikë; ç' dotë më bënë njeriu?,"
- 7 Kujtoni të-parëtë t'uaj, të-cilët' u folnë juve fjalën' e Perëndisë; besën' e atyre kini-e për shëmbëllë, dyke pasurë përpara syvet pemën' e të-sjellavet t'atyre.
- 8 Krishti *është* gjithay dje edhe sot, edhe
- 9 ndë jetët të jetëvet. Mos bihi andej e këtej prej mësimesh të-ndryshme të-huaj; sepse *është* mirë të forconetë zëmëra juaj me hir, e jo me të-ngrëna, ndë të-cilat sa ecnë nukë panë *ndonjë* dobi.
- 10 Kemi një therore, prej së-cilësë s' kanë pushtet të hanë ata që adhuronjënë ndë
- 11 tendët. Sepse trupat' e atyre shtëzave, gjaku i të-cilavet bihetë brënda ndë shënjtërorët prej kryepriutit për faj, digjenë jashtë fushatësë. Përandaj edhe Jisuj, që të shënjtëronjë llauzinë me anë të gjakut të ti, pësoj
- 12 jashtë portësë. Letë dalëmë pra tek ay jashtë fushatësë, dyke mbajturë dhunën' e ati.
- 13 Sepse nukë kemi këtu qytet që mbetetë *përherë*,
- 14 po kërkujmë atë që ka për të ardhurë. Me anë t'ati pra letë biemë gjithënjë te Perëndia

- kurban lavdie, do-me-thënë, pemë buzësh, që
- 16 rrëfenjënë emërin' e ati. Edhe mos harroni të bëni mirë e t'u epni ndihmë *të-vobeqvet*, sepse mbë të këtillë kurbanë gjen pëlqim Perëndia. Binduni ndë të-parët t'uaj, edhe dëgjoni-ni; sepse ata rrinë sqjuarë për shpirtëratë t'uaj, sepse ata kanë për të dhënë fjalë; që t'a bënënjë këtë me gëzim, e jo dyke pshërrëtiturë; sepse këjo nuk' u bënë dobi juve.
- 18 Faluni për ne; sepse na është mbushurë mëndja, se kemi ndërgegje të-mirë, dyke dashurë të sillemi mirë mbë gjithë punërat.
- 19 Po më tepërë u lutemi juve t'a bëni këtë, që të kthenem ndër ju më çpejt.
- 20 Edhe Perëndia i paqtimit, i-cili ngriti prej së-vdekurish barin' e-math të dhënvet me anë të gjakut të dhjatës' së-përjetëshme,
- 21 Zotinë t'ënë Jisu Krisht, U bëftë juve të-sosurë mbë çdo punë të-mirë, që të bëni dashurimin' e ati, dyke punuarë ndër ju atë që është e-pëlqyerë përpara ati, me anë të Jisu Krishtit; mbë të-cilinë *qoftë* lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.
- 22 Edhe u lutem juve, o vëllezër, duroni fjalën' e këshillësë; sepse me pak fjalë u shkrova juve.
- 23 E dini se vëllaj Timotheu ulëshua *nga burgu*, më të-cilinë, ndë arthtë më çpejt, dot' u shoh juve.
- 24 Ep-u-ni të-fala me shëndet gjithë të-pa-

rëvet t'uaj, edhe gjithë shënjtorëvet. U falenë
me shëndet juve ata që janë nga Italia.

25 Hiri *qoftë* me ju të-gjithë. Amin.

